**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**Kuvendi i Komunës**
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr. 60/01-11872/24**
**Kaçanik, 22.05.2024**

## FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 31.05.2024 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

______________________

Në mbledhjen e V (pestë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 31.05.2024 do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

2. Draft Statuti i Muzeut të qytetit të Kaçanikut;

3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024;

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024;

5. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 ne buxhetin e vitit 2024;

6. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes "Migros Group" me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;

7. Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku;

8. Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "KAÇINKA" L.L.C;

9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" OP;

10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "JLG CONSTRUCTION" SHPK;

11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P "X-PLAST";

12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI";

13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-9223/24
*Kaçanik, 29.04.2024*

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.04 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsye: Lejla Çaka-Muhaxheri dhe Ernesta Krasniqi.
Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi dhe Mavije Murseli.
Nga OSBE, në mbledhje mori pjesë, Faruk Dërmaku.
Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.
Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, me arsye mungojnë dy anëtarë, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 29.04.2024, me këtë:

**REND PUNE**

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, Burim Shehu;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
3. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;
5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi;
7. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2023.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

**z. Agim Mani:** Pika e 7 Raporti i Komitetit për Komunitete na ka ardhur me vonesë, kjo pikë nuk na ka ardhur në KPF. Me intereson të di, a votohet ky raport?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti i Komitetit për Komunitete nuk shkon në procedurë të KPF, ndërkaq votohet, se ky komitet është formuar nga KK dhe i raporton KK.

**z. Agim Mani:** Atëherë, ne grupi i LVV jemi të pajtimit që kjo pikë të diskutohet në këtë mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**APROVOJ**

**Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1.Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, Burim Shehu;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E ftoj anëtarin e zgjedhur nga LVV, Burim Shehu, të ngritët në këmbë dhe të lexoj deklaratën e Betimit Solem për anëtar të KK, ndërkaq në shenjë respekti për betimin e anëtarit të KK, i ftoj të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë.

**z. Burim Shehu-** Anëtar i zgjedhur e KK nga LVV, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimin Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: "Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Deklarata e Betimit Solemn u nënshkrua nga Burim Shehu/ Lënda: 01Nr.60/01-10046/24.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Falënderoj anëtarin e ri të Kuvendit të Komunës, Burim Shehu për Betimin e dhënë, i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;

**Ndryshim Plotësimet e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së shtatë (7) të KK, të zgjedhur me 17 Tetor 2021/ Lënda: 01Nr. 60/01-10048/24.**

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ( KQZ) Nr. 01/504-2024 të datës 13.04.2024 pranuar me 15.04.2024 me numër të protokollit të komunës 01Nr. 60/01-9920/24, anëtari i dorëhequr nga LVV, Adnan Reka, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i LVV, Burim Shehu.

Anëtari i Kuvendit të Komunës, Burim Shehu nga data e dhënies së Betimit dhe nënshkrimit të Deklaratës solemne, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin, ndërkaq anëtari Adnan Reka pushon të jetë anëtari i KK sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 me vendim të KQZ Nr. 01/504-2024 të datës 13.04.2024.

Të gjithë anëtarët e KK që e morën fjalën për pikat në vijim, fillimisht e uruan anëtarin e ri të KK, Burim Shehu, i dëshiruan shëndet dhe suksese në aktivitetin e punës së KK.

**2**. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni:

**z. Agim Mani:** Meqë nuk kemi marrë pjesë në mbledhje, nuk do të marrim pjesë në votimin e procesverbalit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbalin e mbledhjes se kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua pa vërejtje, me shumicë votash Për, Kundër votë nuk pati, Abstenim nuk pati. Nuk votuan 6 anëtarë të LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 29.03.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-7034/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

**Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** 1. Nuk mundem pa e vënë në diskutim publik, qarkullimin 1 kahe të rrugës “Qamil Ilazi”, e cila u testuar që 1 vit. Uroj që investimet kapitale që nxisin debat të madh publik, që prekin interesin e përgjithshëm, kur kritika të vjen edhe nga subjektet opozitë, të merret parasysh dhe të trajtohet me arsyeshëm, se gjithë ne jemi qytetarë të kësaj komune dhe ne përveç që delegohemi, duhet me dhënë përgjegjësi para qytetarëve të cilët na besuan votën e tyre.

2. Kërkoj të merren veprime të nevojshme për pastrimin e ambientit rreth përmendores në lagjen e Re, sepse vendi ku qëndrojnë qytetarët dhe vizitorët, është i papërshtatshëm dhe largpamësia kundrejt përmendores është e paarritshme. Besoj se pajtoheni, se edhe ju që ishin prezent aty, e kishit të pamundur pamjen.

3. Kërkesa nga Lagjja ”Besnik Begunca”- lagja e re, ku qarkullimi i njerëzve, kryesisht i fëmijëve për në shkollë është mjaft i madh, rruga e ngushtë dhe pa trotuar, shkakton vështirësi dhe rrezik për ta. Po flas konkret në Rrugën “Burim Rexha”, në drejtim të xhamisë së dëshmorëve, ku në dy anët e rrugës janë pusetat e ujit të hapura. Kërkoj nga zyrtarët kompetent të dalin në vendngjarje, të vlerësojnë gjendjen dhe sipas mundësisë të intervenojnë për rehabilitimin e rrugës.

**z. Selajdin Troni:** Të çështja e pastrimit të ambientit që u kërkua të përmendorja e dëshmorëve në Lagjen e Re, kemi kërkuar me u pastruar, por nuk mundesh në pronë private me u marrë me pastrimin e ambientit. Ata si lagje-familjet e kanë dhënë një mundësi me shpronësuar atë pronë, na kanë ftuar para 10 ditëve. Atë pronë mundëm me bërë pronë të komunës dhe me na shërbyer në atë ardhmen për manifestime.

**znj. Ardita Rrahmani:** Faleminderit për përgjigjen si kolegë dhe anëtar i KK. E di se prona është private, e di me pika se kujt i takon. Mendoj se nëse ishte diskutuar me familjarët, se krejt çka u diskutua është me u prerë drunjtë (6 copë). Nëse ishte diskutuar me herët kjo çështje, duke njohur familjen, besoj se do të kishit hasur në mirëkuptim. Kjo lë të jetë thirrje për hera tjera, se me shpronësimet janë organet që duhet me u marrë, jo unë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kam 3 pyetje për organet përkatëse:

1.Ndriçimi publik të Stacioni i autobusëve, në rrugën “Vëllezërit Çaka” përgjatë urës mbi lumin Lepenc, nuk është duke funksionuar që një kohë të gjatë, ndërkaq qarkullimi i qytetarëve dhe nxënësve është mjaft i madh, arsyet nuk i di pse nuk funksionon ndriçimi publik.
2.Çka keni vepruar me pronat që janë shpronësuar rreth ndërtimit të autostradës “Arbën Xhaferi” se për të njëjtat prona, qytetarëve iu shkojnë ende faturat e tatimit në pronë edhe pse ka raste kur shtëpitë janë rrënuar.

3.A është në projekt, Ndërtimi i përroit të fshatit Kovaçec, që kalon afër shkollës fillore, se paraqet rrezik për objektet e banimit aty afër, pasi që me rregullimin e autostradës është shtuar dukshëm sasia e ujit që mblidhet nga reshjet atmosferike, për shkak të devijimeve që i ka bërë “Bektel Enka”?

**z. Naim Beça:** Desha me ua përkujtuar të gjithëve se sot kur e dha betimin, Burimi, mos harroni se krejt na jemi nën betim dhe ndoshta do të kishte nevojë ai betim të lexohet në çdo mbledhje, me ditur për çka jemi këtu. Pyetjet:

1.Herën e kaluar e kam bërë një pyetje, përgjigjen nuk e kam marrë. Pyetja ka qenë për të gjitha projektet të cilat janë nisur dhe nuk kanë përfunduar. Pyetja ka qenë nga qytetarët e komunës, cilat projekte kanë filluar, të ceken me emër dhe deri ku kanë arritur realizimi i tyre dhe pse janë ndalur.

2.Kërkesa e dytë e qytetarëve, është çështja e urës të Përroi i Rakocit-ura për këmbësor. Në vitin e kaluar kam kërkuar në tre seanca me u rregulluar ajo urë, por nuk është rregulluar. Cili është problemi, se njerëzit qarkullojnë aty natën, ndërkaq zhurma që vjen nga ura, krijon probleme për banorët aty në prishjen e gjumit dhe qetësisë?

3. Në Rrugën “Sali Bajra” të “BK”, ende iu shkojnë tatimet me u paguar lokaleve që me herët kanë qenë në rrugën ish “Emin Duraku” përballë shkollës. Lokalet e tyre janë rrënuar, ndërkaq tatimi iu shkon. Ku është problemi, pse me i ngarkuar ende me fatura dhe kamata?

4.Kërkoj me marrë veprime të nevojshme për çështjen e sigurisë së qytetarëve nga qentë endacak, se janë shtuar me të madhe, ndërkaq askush nuk merret me ta. Duhet me u marrë me këtë çështje, se ky është një problem shumë serioz dhe paraqet rrezik për qytetarë.

5.Kërkesa tjetër e qytetarëve është, për çështjen e pastrimit të rrugëve. Rrugët janë shumë pa pastërti për shkak të vërshimeve që ka pasur në disa ditë dhe të kanalizimeve. Kërkoj të organizohet komuna për pastrimin e korzës të qytetit dhe rrugën” Sali Bajra”. Ne jemi pas kuptuar për mirëmbajtjen e korzës të qytetit nga kompania, por nuk është pastruar asnjëherë. Kjo paraqet rrezik për qytetarët, andaj kërkoj të merrni masa se gjendja është shumë alarmante.

**znj. Arta Avdiu:** 1. Pyetje për Kryetarin e komunës, edhe pse nuk është këtu. Ne e dimë që Kryetari i komunës përmes procedurave të prokurimit ka angazhuar për këshilltar ligjor përmes procedurave, ish kandidatin e LDK për kryetar komune z. Shkëlqim Jakupi. Si anëtare e KK kërkoj t ‘na i dërgoni këto dokumente: Kontratën në mes palëve, pagesat që i janë bërë të kontraktuarit-shpenzimet, raportin e opinioneve dhe këshillave ligjore që bërë i kontraktuari në atë funksion.

2. Kam pasur një kërkesë, për të cilën nuk kam marrë përgjigje, po e përsërisë prapë. Kam informata se disa komuna të Kosovës, si: Theranda, Obiliqi, Ferizaj, Skenderaj, Hani i Elezit, Kamenica, Prizreni, se fundi edhe Vushtrria nëse nuk gaboj, që kanë ndarë nga buxheti i tyre një shumë të mjeteve buxhetore, për çdo fëmijë që vjen në jetë, në përkrahje të nënave lehona. Pse mos të ndiqet një praktikë e tillë edhe në komunën tonë? Andaj, kërkoj nga kryetari që të shikohet mundësia e ndarjes se mjeteve buxhetore për fëmijët e porsalindur, pasi kjo do të jetë një mbështetje për të gjithë prindërit e komunës tonë.

**z. Rrustem Zenuni**: Kam një pyetje për Ekzekutivin e komunës lidhur me thirrjet e ministrive, që kanë hapur thirrje për komunat që të aplikojnë me projekte, konkretisht me ministrinë e infrastrukturës që iu kemi drejtuar me disa kërkesa. A keni marrë ndonjë përgjigje pozitive apo jo, që mos të përjashtohemi ne si komunë nga ato thirrje?

**znj. Ardita Rrahmani:** Lidhur me pyetjen e znj. Arta Avdiu, e kam për obligim me ia bërë të qartë asaj, grupit të LVV dhe gjithsecilit që po na përcjellë se z. Shkëlqim Jakupi ka dhënë dorëheqje nga LDK në tetor të vitit 2021 dhe e ka vazhduar punën si avokat ku është i licencuar prej Odës së avokatëve. Në punën e tij për të cilën ju po pretendoni i vëreni se cilat janë pagesat, por kjo është në përgjegjësi të komunës me iu dhënë informata.

**z. Agim Mani:** E kam një pyetje për DUKMM, Kërkoj nga drejtori t 'na sjellin, Projektin për rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale dhe rurale, pasi që ky projekt tani është në fazën e procedurave të tenderimit.

**z. Agim Çaka:** 1. Pyetja e parë ka të bëjë me trajtimin e mbeturinave në përgjithësi në komunën tonë. Për kundër faktit që këtë problematikë e kemi trajtuar në shumë seanca të KK, prapë se prapë mbetet çështje e pazgjidhur. Në mungesë të deponisë legale të mbeturinave, qytetarët kanë filluar të hedhin mbeturina në hapësira të padukshme dhe të dukshme. Në këtë drejtim janë formuar deponi "legale"(në thonjëza) në disa pika: në rrugën "Idriz Seferi" në drejtim të lumit, ku mbeturinat shtrihen përgjatë rrugës dhe nën ujë deri të lumi. Të Guri i Shpum, me saktësisht pjesa e rrugës për Ivajë dhe magjistrales për Han të Elezit, Një pikë është mbi lagjen Zeneli të Përroi i Çakëve, një tjetër të Përroi i Çakëve buzë magjistrales, tjetra në lagjen e re Teneç, një në Runjevë, ka edhe në pjesë tjera që nuk i përmenda. Pyetja ime është; A ka plan Ekzekutivi i komunës për sigurimin e një deponie legale dhe menaxhimin e saj? A ka plan konkret Ekzekutivi i komunës për ndalimin dhe largimin e deponive të krijuara?

2. Pyetja e dytë ka të bëjë me Subvencionet në sektorin e Bujqësisë. A kanë shkuar në vendin e duhur subvencionet, a janë ndarë atyre që e meritojnë? Cili është mekanizimi që drejtoria e Bujqësisë mund të përdorë për ndalimin me abuzimin e pajisjeve të përfituara nga subvencionet? Nëse dikush i ka shitur pajisjen e përfituar nga subvencionet, kjo i bien se ai nuk ka pasur nevojë për atë subvencion, ndërkaq përgjegjësia bien të ai që i ka ndarë subvencionet në mënyrë jo të drejtë dhe nëse mund të themi ka abuzuar me subvencionet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

**3.** Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;

Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, Raporti është diskutuar edhe në KPF, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pyetje për drejtorin e financave, të HVK janë në shumë 924,200€, ndërsa nga raporti shihet se janë inkasuar 148,506.61 €. Ku qëndron problemi për një inkasim të ulët të këtyre të hyrave, pasi ka kaluar tremujori i parë dhe vetëm 16.07% e të hyrave të planifikuara janë inkasuar? Sa është borgji i gjithmbarshëm i tatimit në pronë?

**z. Agim Mani:** Inkasimin e dobët të HVK e potencoj znj. Kadrije. Ky raport është me i kompletuar, sepse ai i vitit 2023 nuk e ka pasur listën e Investimeve Kapitale-IK, ndërsa në këtë raport është lista e IK, por shpenzimi është vetëm 2.6% të ky program buxhetor. Për IK janë të planifikuara mbi 3 milion euro, ndërsa investimi është 2.6%. Nëse vazhdohet me këtë trend, kanë me ngelë mjete buxhetore në suficit apo bartje të mjeteve, apo do të mundoheni me i shpenzuar mjete, me bërë eksperimente të secili projekt, ashtu si keni vepruar në të kaluarën. Të Mallrat dhe shërbimet nuk është njëjtë, janë shpenzuar me shumë mjete, sepse e keni pasur me lehtë. Janë të paqarta shpenzimet e krijuara për gjoba të gjykatës. Në mungesë të vetëdijes apo kapacitetit, keni paguar gjoba gjykatës 27,222€ për tre muaj. Në anën tjetër thuhet që, komuna në mungesë të kapaciteteve intelektuale profesionale, ka paguar edhe shërbime të ndryshme intelektuale. Të mirëmbajtja dimërore e rrugëve, janë shpenzuar 106 mijë euro, ndërkaq borë nuk ka pasur pos njëherë, kjo është e pakuptimtë. Këtu ka qenë me lehtë me i

shpenzuar mjetet, se kontrata ka qenë 2 vjeçare. Pyetje për drejtorin, Çka janë shpenzimet për anëtarësim, shpenzimi i krijuar nga Zyra e Kryetarit?

**z. Naim Beça:** Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, shuma 160 mijë euro, për projektet: Furnizimi me aparatura për QKMF, Blerja e veturës për kujdesin pariativ, këto janë me buxhet, por nuk janë realizuar. Unë kam kërkuar njëherë me u realizuar këto projekte.

**z. Bashkim Luma:** Të raporti financiar, nuk po i marrim krejt të dhënat për projektet e realizuara në fshatra apo në tërë territorin e komunës së Kaçanikut. Kërkoj t' me ofrohet një raport për projektet e realizuara në vitin 2023 për f. Glloboçicë, ashtu siç ka qenë i hartuar një raport për projektet e realizuara në vitin 2021 dhe 2022.

**z. Naim Beça:** Të kategoria ekonomike e shpenzimeve, çka është rezerva komunale?

**z. Bahri Selimi:** Rezerva komunale, kur e miratojmë buxhetin, janë do projekte që nuk kalojnë prej ministrisë, dhe ato i lënë në rezervë që ne gjatë këtij viti përmes vendimeve të KK ato mjete me transfere të destinohen. Ato mjete nuk humbin, por mbesin në kategorinë rezervë. Ka qenë projekti për blerjen e një kamioni për kompaninë "Pastërtia". Projekti sipas ministrisë nuk i ka plotësuar kushtet, mjetet duhet me u ridestinua me vendime të KK dhe do t'i ridestinojmë.

**z. Naim Beça:** A është vendosur për kamionin apo jo, pse nuk e merrni parasysh edhe kamionin e zjarrfikëseve?

**z. Bahri Selimi:** E gabova, se është fjala për ndërtimin e garazhës. Në mbledhjen vijuese kemi me sjellë Propozim Vendimin për ridestinimin e shumës 25,000€. Të shëndetësia, është shtylla e projekteve kapitale, në anën tjetër e kemi pozicionin sa janë shpenzuar mjetet. Janë të parapara të shëndetësia diku 160,000€ investime: Furnizimi me aparatura për QKMF, Blerja e veturës për kujdesin pariativ dhe Ndërtimi i garazhës dhe depos në QKMF. Këto projekte planifikohen sivjet me u realizuar. Të IK, Bashkim, a kërkoni raport vetëm për f. Glloboçicë? Të pyetja e Agimit, IK 2.6% u përmend edhe në KPF, nuk kemi pasur obligime të viteve paraprake, mjetet janë të shpenzuara për projektet e sivjetme. Nëse e krahasojmë shpenzimet buxhetore me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, del se kemi progres, në masë monetare janë shpenzuar mbi 74,000€ me tepër. Ne nuk bëjmë aneks kontrata vetëm me shpenzuar buxhetin, këto nuk janë të vërteta se aneks kontratat e kanë një procedurë, si: kërkesa, zhvillimi i procedurës së prokurimit. Nuk mund të themi se nuk kemi aneks kontrata gjatë vitit, por jo në fund të vitit sa me shpenzuar buxhetin. Të MSH janë shpenzuar 235,941.96€, jo se është me lehtë me shpenzuar këtu, por disa shpenzime rrjedhin natyrshëm nga obligimet e komunës për aktivitete të komunës, si; furnizim të zyrave, furnizim të çerdhes së fëmijëve me ushqim, mirëmbajtje të veturave, derivateve. Shpenzimet për anëtarësim, është Asociacioni i komunave, janë 5,000€ të shpenzuara, është pagesa vjetore për kokë të banorit, shpenzimi është të Zyra e Kryetarit. Zakonisht i bëjmë pagesat në 6 mujorin e parë, se edhe ky është një element për vlerësim të Grantit të përformancës. Gjobat e gjykatave, edhe në KPF e keni ngritur këtë pyetje, janë dhënë 27,000€, shuma kryesore e tyre janë tërhequr nga thesari i Kosovës, ndërkaq 12,000€ të shërbimet publike, 6,000€ janë shpenzime gjyqësore, 12,321€ ka të bëjë me një projekt të tërhequr të vitit 2020- mirëmbajtja e rrugëve urbane dhe lokale, është ankuar operatori ekonomik për disa punë që i ka kryer, dhe na i ka marrë me përmbarues. Në vazhdim drejtori Selimi e përmendi operatorin ekonomik dhe përmbaruesin. Shuma 3,672€ të shërbimet publike janë tërheq mjete nga përmbaruesi privat për Q. Koraqi, për një parcelë. Për parcela janë tërheq mjete administrata, nga përmbaruesi privat nga shuma, 7290€ për S. Luzha. Gjithashtu janë tërheq mjete të shëndetësia për Kemal H. 2700€ për pagën jubilare sipas kontratës kolektive. Jemi në obligim të arsimtarëve, stafit shëndetësor për disa obligime në bazë të kontratës kolektive dhe pagës jubilare, se nuk janë ekzekutuar me kohë dhe kanë vazhduar me përmbarues privat. Të rrugët lokale, mirëmbajtja e tyre, do të porosisë drejtorin është diku 106,982€. Për 43,000€ i kemi shpenzuar me tepër, krahasuar me vitin e kaluar. Rritja

e shpenzimeve është edhe element i përbashkët i ngritjes së çmimeve të kontratave. Shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse, e ndërlidhe me gjobat e gjykatave, nuk ka të bëjë me këtë. Ne, nëse e kishim paguar ekspertin e jashtëm, Shkëlqim Jakupin për disa raste specifik, këtu të shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse nuk është se na ka mbrojtur dikush për këto raste, por nuk ka të bëjë me këto, por janë shpenzime për administratorët e fshatrave, KKSB dhe për anëtarët e komitetit të Auditimit. Të pyetja e Kadrijes, kanë qenë obligimet që na kanë për tatimin në pronë, bizneset, qytetarët. Borgj i TP është afër 1 milion e 700 mijë euro. Këtë informatë e keni pasur me kohë, ka mundur të iu ikë. Borgje të vjetërsuara, këtu ka kamata-interes, gjithkush që ka borgj mbi 300€, jemi të obliguar nga ministria e Financave me dërguar në përmbarues. Në këtë vit janë ndërprerë procedurat përmbarimore, komuna i udhëheqë do procedura tjera, qëllimi kryesor është me i mbledhë komuna borgjet. Të HVK 148,508.61€, nuk është shqetësuese shuma e inkasuar, se besoj se kemi me tejkaluar inkasimin sikur në vitin paraprak.
**z. Rrustem Zenuni:** Të çështja e përmbarimit, kur qytetarët po kanë ndonjë kontest, komunën po e dërgojnë në procedurë përmbarimore, ndërkaq pse komuna mos me pasur të drejtë me i dërguar borgjëlinjtë në procedurë përmbarimore? A është nxjerrë ai ligj tani, se është interes i imi me ditur?
**z. Bashkim Luma:** Të investimet kapitale, kërkoj raport për projektet kapitale të realizuara në Glloboçicë në vitin 2023. Shpenzimet të pozicioni, mallra e shërbime, drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje, ka një diferencë bukur të madhe nga viti 2023. Në vitin 2024 janë diku 24,000€ ndërsa në vitin 2023, vetëm 3,000€, d.m.th. 21,000€ me tepër në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023. Kërkoj sqarim për këtë shpenzim.

**z. Agim Çaka:** Shpenzimet e realizuara në TM1 janë 16,97%, të cilat shpenzime ndërlidhen me aktivitetin e komunës. Sipas kësaj del se, nëse vazhdohet me këtë ritëm, deri në fund të vitit realizimi do të jetë 68-70%, që i bien se nuk do të mundem me shpenzuar buxhetin e planifikuar. Ndërsa krahasuar me vitin 2023, del se sivjet kemi shpenzuar 23.9% me tepër mjete. Nga raport e tremujor që e marrim të vitit pasues, na tregon se viti paraprak nuk ka qenë i mirë me shpenzime, në raport me vitin që pason sa i përket shpenzimit të mjeteve financiare dhe në fund ngelin mjete të pashpenzuara e si përfundim del se nuk po punohet sa duhet.

**z. Bahri Selimi:** Agim, kur e krahasove shpenzimin nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, sivjet kemi shpenzuar në masë monetare me tepër, 391,000€. Vitin e kaluar ka qenë buxhet tjetër, buxheti ka qenë me i vogël. Nuk është që ne vit për vit e paraqesim dështimin e vitit të kaluar. Vjet kemi shpenzuar me pak, buxhet ka pasur me pak, sivjet kemi shpenzuar me tepër, por buxhet ka me tepër. Buxheti 2024 me 2023 e dimë se është 12% me i lartë, për shkak të ligjit të pagave. Sivjet kemi afër 400,000€ të shpenzuara me tepër, vjet me pak, por nuk do të thotë se nuk kemi qenë mirë edhe vjet me realizimin e buxhetit.

**z. Agim Çaka:** Unë nuk u ndërlidha me projekte konkrete as me vlerë monetare, por me përqindje, si dinamikë e shpenzimeve për periudhën kohore.

**z. Ekrem Livoreka:** Për KKSB që u përmend se janë ndarë mjete. Unë jam anëtarë i KKSB, por nuk paguhem për mbledhje në KKSB. Kërkoj një informatë nëse ka mundësi sesi paguhen anëtarët e KKSB?
**z. Naim Beça:** Pyetje për drejtorin: Kohëve të fundit po flitet se arsimtarët kanë me bërë një ankesë. A keni ndonjë strategji që nëse arsimtarët fitojnë me atë ankesë, mos me u dëmtuar komuna, sepse sa e di unë janë diku 3 milion euro në pyetje? Nëse fitojnë, ata shkojnë me përmbarues privat. A ka ndonjë strategji komuna që me i paguar, pa u dëmtuar ndonjë pozicion i buxhetit, si pagat etj. dhe prej cilës kategori paguhen, nëse fitojnë?

**z. Bahri Selimi:** Deri në vitin e kaluar ka qenë një UA që çdo borgj mbi 500€, me dërguar në përmbarues. Ne, duke ditur potencialin e qytetarëve tonë, nuk i kemi dërguar në procedurë

përmbarimore. Tani janë grumbulluar borgjet, kjo nuk është mirë. Sivjet ka dal UA i ri që e ka shfuqizuar UA të vjetër, sipas të cilit, ne nuk guxojmë me i dërguar në përmbarim ata që kanë borgje për tatimin në pronë, se është një procedurë tjetër që ka me udhëheqë komuna.

**z. Rrustem Zenuni:** A mundet me na dëmtuar kjo si komunë në inkasim të HVK, se siç e dimë edhe në vitin e kaluar ka qenë kriteri për regjistrim të automjeteve? Unë nuk jam me u dëmtuar qytetari jashtë ligjit, por edhe komuna me inkasuar të HVK, se mjetet janë pjesë e punës së investimeve tona. Brenga ime është se, po dëmtohemi si komunë ne, por edhe qytetarët.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë do çështje të cilat nuk varen nga niveli lokal, por nga ai qendror. Mbledhja e detyrueshme është bllokimi i llogarisë bankare dhe përmbaruesit privat nuk bënë diçka tjetër. Kjo është me e lehtë për komunën, që qytetari mos me paguar edhe përmbaruesin. Tani, besoj se komuna ka të drejtë me bërë direkt kërkesën për bllokim të një llogarie që në këtë rast qytetari nuk dëmtohen nga taksa përmbarimore. Mendoj se është formë me e lehtë e mbledhjes se detyrueshme me atë të ATK që ndodhë.

**z. Agim Mani:** Drejtori me herët e potencoj si progres investimin kapital, krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2023 ka qenë 2.2% IK, në vitin 2024, 2.6% IK të shpenzuara. Kjo është shqetësuese, sepse vetëm 2% është investuar në kapitale. Të mirëmbajtja e rrugëve, janë shpenzime të mëdha 106,000€, ndërkaq vetëm 1 herë ka rënë borë dhe pastrimi i rrugëve nuk ka mundur me kushtuar kaq shumë. Për atë gjykata për mirëmbajtje të rrugëve, ua ka marrë 60,000€ në vitin 2022 që e potencoj drejtori. Të shpenzimet intelektuale, nëse komuna nuk ka kapacitete, është mirë me paguar ekspertë nga jashtë 10,000€ se i kursen 17,000€.

**z. Bahri Selimi:** Të pyetja e Bashkimit, të drutë, qysh e di, janë paguar kontratat e vitit të kaluar, për dru dhe materiale të drurit, siç janë peleti etj.  nga DA, shuma afër 24,000€, pagesa është kryer.

**z. Bashkim Luma:** Sa e kuptova drejtor, kjo është një planifikim për vitin e ardhshëm. Unë desha me ditur krahasimin e shpenzimeve të vitit 2023 me 2024?

**z. Bahri Selimi:** T'i dërgoj me saktë me shkrim të dhënat Bashkim, për çmimin dhe sasinë.
Të pyetja e Ekremit për KKSB, ju jeni anëtarë i brendshëm, ndërkaq ministria lejon vetëm anëtarët e jashtëm me u paguar, ai që nuk merr pagë nga buxheti i shtetit. Janë paguar administratorët e fshatrave për vitin e kaluar, diku mbi 500€  një administrator për 3 mbledhje, 176.40€ një mëditje, ndërkaq i kanë mbajtur 5 mbledhje. Gjithashtu janë paguar të gjithë anëtarët e Komitetit të auditimit të brendshëm.

**z. Ekrem Livoreka:** Prej kur ka filluar pagesa për ta?

**z. Bahri Selimi:** Sivjet kemi filluar me i paguar administratorët e fshatrave. Anëtarët e Komitetit të Auditimit i kemi paguar. Me herët ka pasur një dallim të komiteti i auditimit, se është paguar vetëm Fitorja, ndërkaq tani me një Qarkore të veçantë të ministrisë së Financave, anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm paguhen të gjithë. Edhe anëtarët e brendshëm të këtij komiteti, paguhen, pavarësisht se marrin pagë nga buxheti i shtetit.

**z. Ekrem Livoreka:** Arben Thaqi është në Komitet për Komunitete nga OJQ, por nuk paguhet.

**z. Bahri Selimi:** Arben Thaqi është staf i komunës, nuk është OJQ. Arbeni merr pagë nga buxheti i shtetit. Unë e përmenda që vetëm anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm është lejuar me u paguar edhe anëtari i brendshëm nga komuna (shërbyesi civil), për tjerat vlen neni 80 i LMFPP. Kemi me pasur problem tani që edhe anëtarët e jashtëm nuk kemi me mundur me i paguar, në anën tjetër i destimulon anëtarët e komiteteve, se ata nuk bëjnë punë shtesë pa

pagesë, e kjo na e vështirëson realizimin e aktiviteteve. Njëherë përnjëherë jemi duke pasur problem me MEF, konkretisht me thesar. Krejt këto komisione flitet me pasur mundësi me i futur në një listë të pagave, që është listë e rregullt e komunave, atëherë bëhet zgjidhje, por për momentin nuk kemi zgjidhje.

**z. Selajdin Troni:** Këtu është e shënuar se 4 anëtarë të Komitetit për Komunitete janë kompensuar sipas UA për kompensimin e stafit politik në komunë, me përjashtim të anëtarit nga OJQ, ku thuhet se është përcjellë raporti i pjesëmarrjes nga Sektori i KK drejtorisë, dhe ka shprehur se ka marrë konfirmim se nga aspekti ligjor i takon kompensimi, mirëpo procedurat për pagesë, kanë filluar të bëhen përmes listës së pagave, që kjo nuk është e drejtë. Këtë ma keni thënë drejtor, por nuk është aprovuar nga Divizioni i pagave në thesar, pasi pagesat duhet të bëhen nga përmes SIM për mallra dhe shërbime dhe këto do të paguhen kur të alokohen mjete me buxhetin e vitin 2024.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe KKSB, janë në kuadër të komunës, ndërkaq nuk e kam të qartë për detyrën që e ushtrojnë, dikush paguhet dikush jo. A janë paguar nga komuna Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe KKSB apo nga ministria e financave?
**z. Bahri Selimi:** Komiteti i Auditimit të brendshëm është paguar prej komunës, e kemi dokumentin që na i lejon me marrë vendimin me i kryer kompensimin. Për këto tjerat, deri tani e kemi pasur të ndaluar me i paguar ata që marrin pagë nga buxheti i shtetit, qoftë arsimtarë, staf shëndetësorë, apo shërbyes civil i komunës, se vërtetë ai e kryen një punë dhe i takon, por tani pos tyre, edhe anëtarët e jashtëm kemi me pasur problem me i paguar, derisa të hynë në fuqi kjo përmes listave për angazhime ekstra në punë. Ka mbetur ministria e Financave me i sqaruar këto punë. Ne i quajmë obligime të komunës këto, se e dimë se janë angazhuar, kanë punuar, në aspektin tonë moral i themi, obligime. Me e thirrur për kompensimin e pagave dhe mëditjeve është Zyra e personelit dhe janë dërguar me u ekzekutuar, por nuk janë ekzekutuar. Është Arbeni, por ka edhe të tjerë që nuk janë paguar. Të çështja e shqetësimit rreth padisë së arsimtarëve. Arsimtarët e komunës tonë, paditë i kanë bërë ndaj komunës. Të drejtën ia mundëson kontrata kolektive e arsimit. Bëhet fjalë për kohën e inflacionit, shujta, kualifikime. Shuma e përgjithshme është diku 2 milion euro. Nuk e di qysh ka me u ekzekutuar, a na dërgojnë në procedurë përmbarimore apo qysh. Nga Supremja ka ardhur një vendim, ne nuk mundem me nda mjete për shpenzime kontingjente, e mos me i kryer projektet e parapara me buxhet. Si ekzekutiv kemi bërë njëfarë plani, ashtu që projektet e planifikuara nuk mund t'i lëmë anash, se iu kemi premtuar qytetarëve, çka të kemi mundësi me i kryer, do t'i kryejmë. Lëndët që vijnë për ekzekutim, është fatkeqësi e nivelit qendror që nuk i mbulon, por ua marrin mjetet komunave. Ne kemi pasur raste me herët, ku nga tërheqja e mjeteve, ka pësuar buxheti komunal, nuk ekziston mundësia me u rrezikuar pagat, që e potencoj dikush. Nëse ndodhë ajo nga buxheti i komunës, ne projektet që na ngecin në rastin kur na vinë lëndët për ekzekutim, apo të ndonjë aktiviteti, ku mund të marrim mjete aty, ose në anën tjetër e kemi një premtim nga thesari që mjetet me u tërhequr nga pagat, por në fund të vitit bëhen bilancet dhe nëse kemi të HVK të pashpenzuara deri në atë kohë, i marrin dhe i kompensojnë mjetet. Nëse tërhiqen nga pagat, nuk do të thotë se rrezikohen pagat aktuale, bëhet mbishpenzim i pagave mujore, pastaj kompensohen me buxhetin e pashpenzuar të vitit 2024. Edhe ndonjë projekt ku kemi ngecje, si vitin e kaluar e patëm miratuar parkingun nëntokësor, i cili projekt ka ngecë për shkak të mbetjeve arkeologjike. Aty i kemi 330,000€ të miratuara me u shpenzuar sivjet, ndërkaq nuk shihet se ka ndonjë dinamikë të zhvillimit apo ndonjë përgjigje nga ministria, ato mjete mbesin, nuk është kategori e njëjtë, mundësia e parë me u kryer pagesat është nga ky projekt. Ne nuk e dimë gjykata kur i bien lëndët, kur vendimet bëhen ekzekutues. Për gjimnazin, e di se 30,000€ kanë shkuar në përmbarim në thesarin dhe ata dita ditës mund të kërkojnë se ku me i tërheqë mjetet. Shuma 2 milion mund të zgjatë 3 vjet, e që nuk na dëmton në buxhet, në asnjë mënyrë me u rrezikuar pagat e shërbyesve civil, mundet me marrë mjetet nga IK, Mallra dhe shërbime. Ne si komunë duhet me bërë planin se ku mundemi me kursyer

në ato kategori ku nuk rrezikohet aktiviteti punues. Detyrime janë, por nuk mundem me bërë planin tani, se mundet të shkoj viti e mos t 'na vijnë ekzekutimet. Lëndët janë në gjykatë, ndërsa se kur na vijnë neve, nuk e dimë, mundet të na vijnë në pjesë.

**z. Naim Beça:** Ju po e pranoni se e keni humbur lëndën, arsimtarët e kanë fituar kontestin. Shuma 2 milion është e madhe për komunën e Kaçanikut për mos investim, kështu duhet me bërë njëfarë plani se ku i merrni mjetet.

**z. Bahri Selimi:** Kjo nuk ka ndodhë me fajin e kryetarëve të komunave, por me fajin e ish ministrave. Ne, sa herë kemi debatuar edhe në ministri se këto kontrata janë nënshkruar në nivel ministror, ndërkaq në nivel lokal kërkojnë me u ekzekutuar mjetet, këto ndodhin, ndërkaq dihet se buxhetet komunale dëmtohen. Një shpërndarje me e gjatë nëpër vite, rreziku është me i ulët.
**z. Rrustem Zenuni:** Për çështjen e kontratës kolektive, kam dëgjuar nëpër medie të ndryshme, që komunat përmes Asociacionit të komunave të Kosovës, po shqyrtojnë mundësitë ligjore me paditë ministrinë në gjykatën komerciale. A ka diçka në këtë drejtim, se kjo është një e padrejtë që i kanë ngarkuar komunat.

**z. Bahri Selimi:** Është vendimi i gjykatës supreme që iu ka ardhur komunave për zbatim, disa komuna veç e kanë zbatuar. Dëmi veç bëhet edhe nëse bëhet rimbursimi i mjeteve në vitin vijues, se ta prishë buxhetin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës

**NJOFTOHET**

**Me Raportin tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024/ Lënda: 01Nr. 400/01-9155/24.**

**4.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;

E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Kam 2 vërejtje këtu, njëra procedurale dhe substanciale. Sa e di unë, rendin e ditës e cakton Kryesuesi i KK me Kryetarin e Komunës, ndërkaq Propozim Vendimi nuk është i nënshkruar fare nga Kryetari i komunës. Të dispozitat ligjore, nuk përmendet fare ligji për tokat bujqësore. Të pjesa substanciale, në rast se nuk është përmend ligji për tokat bujqësore, ndërkaq kemi kërkesë për ndërrim destinimi, a është duke u bërë ndërrimi i kulturës apo ndryshimi i PZHK, pasi kjo çështje ka me shkuar në MMPHI si ministri e linjës, a ka me u bërë ndryshimi i PZHK për atë parcelë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore në ato ndërtimore, ato janë të caktuara me ligj, është dashur me u cekur, ka pasur mundësi me u bërë ndonjë lëshim. Ndryshimi i PZHK bëhet, sepse po të ishte me PZHK kjo pronë tokë ndërtimore, nuk do t 'na adresohet këtu. Meqë po ka kërkesa të shumta të kësaj natyre, ndërkaq kemi ngecur si komunë si pasojë e PZHK, deri me miratimin e PZHK të ri, ne t'i trajtojmë kërkesat e qytetarëve, pasi jemi komuna e vetme në Kosovë që nuk ndërtohet. Jemi duke u përballë me një shpërngulje bukur masive të njerëzve, nëpër komunat tjera. Ne po marrim vendim, ndërkaq ministria e shqyrton vendimin, kjo shkon edhe në ministri të linjës se është e klasës 3. Si kërkesa është mirë t'i trajtojmë, se kemi ngecur prapa. Vendimi mendoj duhet përkrahur, edhe pse vendimi duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit të ligjshmërisë, dhe nuk e dimë cila ka me qenë përgjigja e tyre.
**z. Betim Shala:** Unë nuk jam kundër lejimit të ndërtimeve, por si Propozim Vendim mu duk interesant. Duhet me marrë veprime që edhe pa u miratuar PZHK me iu hapur rrugë që me u liruar edhe zonat tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me PZHK të ri, besoj se janë trajtuar ato pjesë, mirëpo meqë ka ngecë PZHK, ne po marrim veprime të nevojshme aq sa mundem me bërë.

**z. Agim Mani:** Drejtori i Urbanizmit është në kundërshtim me Ligjin e vetëqeverisjes lokale, se këto Propozim Vendime duhet me i sjellë në KK Kryetari i komunës e jo drejtori, por kryetari po i ikë përgjegjësisë, megjithatë ky Propozim Vendim nuk ka bazë juridike, përkundër që është thirrur në Ligjin për planifikim hapësinor 04/L-174 nenit 5, pika 1.2. Planifikimi i nivelit lokal për tërë territorin e komunave bëhet përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor, siç janë: Plani Zhvillimor Komunal; Harta Zonale e Komunës; dhe Planet Rregulluese të Hollësishme. Në këtë Propozim Vendim thuhet se prona është tokë bujqësore, ne a duhet me u bazuar në ligj apo në PZHK. Kjo në start bien ndeshë me bazën juridike që e keni marrë. Kjo është pronë e klasës të 3. Edhe kjo bien ndeshë me ligjin, pasi për pronat e klasës 1-4 fillimisht duhet të merret pëlqimi nga ministria, pastaj t 'na vjen në KK, kjo nuk është bërë. Ne jemi për ndërtime të larta në komunën tonë, se kemi ngecë prapa, por jo në këtë formë, se kjo e pengon ndërtimin. Ju sigurisht po e dini se kjo ka me shkuar ne ministri dhe ka me u kthyer, se nëse e dërgoni në këtë formë dhe nuk e rregulloni juridikisht mirë, se me qenë në rregull nuk kthehen, por e hiqni fajin nga vetja dhe ia adresoni ministrisë, kjo nuk është zgjidhje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket procedurës, është në rregull, sa i përket PZHK dhe Hartave zonale, po të ishte e paraparë, nuk do të vinte në KK fare, por që nuk është me PZHK, na vjen në KK. Edhe Rregullorja edhe UA e thotë qartë, se janë do kritere, për të cilat është i thirrur komisioni me i vlerësuar. Komisioni e ka bërë vlerësimin dhe DUKMM e ka sjellë Propozim Vendimin në bazë të vlerësimit të komisionit. Meqë PZHK është miratuar ka kohë, PZHK i ri ka ngecë, atëherë forma e vetme është kjo nga ana e jonë, ndërkaq vendimi shkon në vlerësim të ligjshmërisë. Pëlqimin e ministrisë nuk e di, në të kaluarën kemi bërë ndërrime të destinimit të tokës bujqësore dhe ministria i ka miratuar, ndërkaq kohën e fundit na i ka refuzuar. Detyrë e jona është, me iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve që kanë nevojë me ndërtuar, dhe kërkesat e atyre që donë me investuar. Për pjesën tjetër, janë organet me të larta që e vlerësojnë ligjshmërinë. Munden me na e kthyer, por munden edhe me na e miratuar, se ka pasur shumë raste që na i kanë miratuar, por detyra jonë është me iu përgjigjur kërkesave, sepse PZHK ka ngecë, ndërsa qytetarët po largohen nga këtu.

**z. Qamil Stagova:** Në lidhje me Propozim Vendimin, nuk e di a duhet me edhe nënshkruar Kryetari i komunës, ndërkaq nga koha kur jam drejtor nga fillimi i vitit 2022, në këtë formë janë bërë Propozim Vendimet. Ne jemi duke insistuar me bërë hapa në ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore , sipas kërkesave, ndërkaq se qysh ka me qenë përgjigja, nuk e dimë as ne.

**z. Bashkim Luma:** Desha me thënë se, nganjëherë po dilni nga roli i juaj si kryesues, pasi diskutimi duhet të jetë nga drejtori i Urbanizmit, ndërkaq shumicën e diskutimit po e realizoni ju.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë e kam të drejtën e diskutimit sikurse ju se edhe unë jam anëtar i KK, shumë mirë i di detyrat e mia dhe nuk është hera e parë që grupi i juaj e kanë potencuar këtë çështje. Nuk jeni ju ata që me tregoni a me fol apo jo, ndërkaq nëse iu pengon diskutimi im, ajo është çështje tjetër, bile është mirë me dëgjuar me kujdes kur flas.

**z. Bashkim Luma:** Nuk dua të keqkuptohem, se jeni me përvojë të gjatë në KK, por çështja është se diskutimi doli nga drejtori i DUKMM.

**z. Selajdin Troni:** Duhet me u angazhuar me u kryer sa me shpejtë PZHK, se mund të kemi edhe kërkesa tjera. Për derisa nuk ka PZHK, unë i kisha inkurajuar qytetarët që të aplikojnë për ndërrim destinimi të tokave bujqësore, për ata që kanë me ndërtuar. Nëse na ndalojnë, është e mirë e jona dhe e qytetarëve, e jo në mungesë të PZHK me iu thënë, mos bëni kërkesa e mos i dërgoni në ministri. Nëse kryesuesi e jap një këshillë të mirë, nuk bënë me na penguar.

**z. Agim Mani:** U keqkuptuam, në këtë Propozim Vendim, unë qartë e thashë në fillim, por ju kryesues u munduat me marrë rolin e ekzekutivit. Ju vet i theksuat dy variante, mundet me u kthyer mundet mos me u kthyer nga ministria. Nuk duhet me shkuar me 2 variante, duhet me një variant. Ne, a me vepruar sipas PZHK apo sipas Propozim Vendimit që e keni sjellë këtu. Ju e keni të drejtën me fol kryesues, por ju me u përgjigjur në pyetjet që ia parashtrojmë ekzekutivit. Ti mundesh gjithçka me fol, mundesh edhe politikisht me fol, por jo nga ajo ulëse, se është ulëse e kryesuesit dhe nuk bënë me keqpërdorë. Kjo është ajo që ne po na pengon.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E drejta ime është nga ku flasë. E dyta, asnjëherë nuk e keqpërdori foltoren, nganjëherë e keqpërdori duke iu dhënë hapësirë të madhe me fol edhe atë që nuk duhet, por në anën tjetër, ju në diskutimin tim mundesh me u kyçur në atë që e themi, është apo nuk është kështu, atë e pranoj. A jam duke fol unë si kryesues apo si ekzekutiv, e mbajë unë atë përgjegjësi. Ti mundesh me ma kontestuar diskutimin, por jo në atë kuptimin pse po fol si ekzekutivi. Me treguar ju pse po përgjigjem unë, se drejtori është këtu, drejtori flet për veti, unë flas për veti. Unë nuk flas në emër të drejtorit. Kur diskutoj unë, ju mundeni me u kyçur në atë aspektin përmbajtjesor, kam drejtë apo nuk kam të drejtë. Nuk keni të drejtë me treguar, se unë flas së pari si Kemal Murseli, pastaj si Kryesues i KK. Unë nuk flas në emër të askujt dhe mbajë përgjegjësi për atë që flas. Pse e pengon dikën se flas unë, kjo nuk është arsye që unë mos të flas.

**z. Bashkim Luma:** Ju vet kryesues po e potenconi se nuk jeni i fushës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos më keqkuptoni, Propozim Vendimi kur vjen, vjen me kaluar dhe me shkuar në KK, askush nuk e kontestoj. Ka raste kur është joligjore dhe na e kthejnë. Ne, jemi ndër komunat që kemi me së paku rishqyrtim të vendimeve, mundem me ua sjellë statistikat e raportit të MAPL dhe nuk kemi asnjë procedurë ligjore, si KK e kam fjalën për vendime të KK, raportet janë publike në faqen zyrtare të MAPL. Nuk jemi qysh po diskutohet se ne e shkelim ligjin çdo ditë si KK, atë frymë të paktën jam munduar me e ruajtur. Kur të flas dikush duhet me dëgjuar, unë kam qenë në gjendje me dëgjuar dhe nuk kam ndërhyrë, jam munduar me amortizuar çështjen. Unë sa herë flas në emrin tim, diskutimet janë publike, i dëgjojnë edhe të tjerët.
**z. Rrustem Zenuni:** Është mirë me i sjellë kryesues raportet e MAPL për rishqyrtim të vendimeve të KK.

**z. Agim Çaka:** Të PZHK është një problem që është potencuar disa herë këtu, po na shqetëson edhe neve si anëtarë të KK, se po vijmë në një pozicion se po duam me iu kryer punë qytetarëve, por nuk po kemi mundësi, se nuk po varet nga ne. Ne jemi këtu me iu kryer punë qytetarëve, por nuk mundem ne me u arsyetuar tek qytetarët, ne po duam me kryer punë, por ekziston një nivel tjetër që po na pengon. Në fakt, ai nuk po na pengon, është një problem që ka çështje ligjore dhe nuk mundet me kaluar vendimin. Dërgesa e këtyre lëndëve në ministri, janë si me fat, hajt se ndoshta kalojnë. Nuk është mirë me u praktikuar kjo. Ne duhet me i kryer punët tona. Qe sa kohë po debatohet çështja e PZHK, edhe sot nuk e kam të qartë pse po ngecë kjo, është normale që edhe këtu nuk mundesh me mbajtur mbledhje pa rend dite, sikurse pa PZHK, duhet me pasur edhe Hartat zonale, se këto i ka paraparë dikush dhe ato ndryshohen varësisht prej kërkesave të qytetarëve. Shqetësimi im është, a do të kemi fuqinë me iu ndihmuar qytetarëve, se unë jam dakord me kaluar ky vendim, por qytetarët me ditur që nuk është kjo në dorën tonë. Ata që janë përgjegjës, duhet me ardhur me na sqaruar këtu, pse nuk bëhet PZHK, se ai që e vlerëson anën ligjore, nuk është fajtor, pse nuk e kemi PZHK. Edhe në nivel qendror nuk është mirë me kaluar një çështje që nuk janë ligjore. Ai që i dinë këto çështje profesionalisht, është mirë me ardhur me na sqaruar, ndërkaq për si fjalë e lirë, ne e kemi mandatit për me paraqitur një kërkesë apo shqetësim të qytetarëve, ndërsa në nivel profesional mundemi me gabuar. Gjithmonë jam për diskutim kolegjial për interesin e qytetarëve, që të

zhvillohemi edhe ne si komunë, të punojmë pa i shikuar komunat tjera, t'i kryejmë punët tona të ecim përpara.

**Kryesuesi i Kuvendit:** PZHK ju e dini që kam qenë shtytësi me i madh me dal në diskutim sa me shpejtë, bile e kemi mbajtur një punëtori për këtë çështje. PZHK ka ngelë si proces, planin e ka miratuar KK dhe duhet me pasur mundësi me ndërhyrë në atë plan në raste të veçanta për zhvillimin e komunës. Duhet me na mundësuar me ndërhyrë në PZHK aty ku është me interes, në këtë rast është ndërtimi, se Kaçaniku ka ngecë në ndërtim.

**z. Naim Beça:** Që sa jemi duke punuar pa PZHK?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Që 5 vjet i ka skaduar afati PZHK, 2018-2019, skajshmërish është tejkaluar kjo çështje, por tani nuk duhet të rrimë e të akuzojmë se nuk kemi PZHK, por duhet gjetur rrugë tjera me ecur përpara. Shumë komuna kanë ecur përpara edhe pa PZHK. Ne i kemi ndalur njerëzit në Strazhë mos me ndërtuar në mungesë të PZHK, ndërkaq qysh është ndërtuar fjala vjen Jezerci dhe sot edhe ato që janë ndërtuar në Strazhë janë në shitje, për me shkuar ne vende me të zhvilluara. Nuk jam të shkelën ligjet skajshmërish, por të gjejmë një rrugë për krijimin e mundësive për zhvillimin e komunës. Ky Propozim Vendim iu ka nënshtruar një komisioni profesional, ata kanë dalë në vendngjarje e kanë vlerësuar, por logjikisht në këtë fushë duhet me qenë unik, se është interes i përgjithshëm i komunës, pa e kontestuar çështjen se jemi vonuar në PZHK.
**z. Naim Beça:** Ne jemi anëtarë të KK që 3 vjet. Nuk është faji i jonë që nuk kemi PZHK, faji është i shumicës. Ne e kemi një Propozim Vendim për ndërrim destinimi, ne duhet me votuar kundër, se nuk kemi PZHK, ndërkaq qytetari mendon se ne si LVV nuk po pajtohem. Kjo nuk është e vërtetë, na e sjelli PZHK, se nuk kemi për detyrë këto ndërrim me i aprovuar në KK PZHK.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Lë t 'na bien ministria PZHK me shpejtë se plani është gati. Afati për përgjigje është 30 ditë, jo 5 muaj.

**z. Naim Beça:** Sa e keni pasur ju afatin për hartimin e PZHK, njëjta situatë është tani?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk po e kontestojmë fajin askush, por nuk mund të rrimë peng i këtyre çështjeve.
**z. Selajdin Troni:** Ju si LVV nuk është hera e parë që merrni paga, pa punuar fare. I bojkotoni seancat pa ndarë, po mundoheni me i penguar ndërrimet e destinimit, nuk po vini në debate të PZHK kur po organizojmë. Ju veç po ankoheni, e keni marrë votën e qytetarëve duke u ankuar, ju edhe në përvjetorë të dëshmorëve po shkoni vetëm. Hajde disa çështje t'i vendosim së bashku, se ju vetëm po shikoni me bllokuar proceset.

**z. Betim Shala:** PZHK u miratua në vitin 2010. Mirëpo duke u bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor 2023/14. Në vitin 2023 ka hyrë në fuqi ligji i ri për planifikim hapësinor. Ligjin mundem mos me quajtur legjitim, se u miratua në bazë të një ligji tjetër. Tani kur e kemi pyetur ministrinë se me cilin ligj të veprojmë, ata na patëm thënë: vazhdoni me këtë plan. Ligji i ri për planifikim hapësinor, e ka një nen, ku e lejon revidimin e planit. Përderisa u bllokua PZHK, ata duhet me lejuar revidimin e PZHK të vjetër sa është në fuqi, sesa me vepruar me vendime me formën e ndërrimit të destinimit.

**z. Brahim Imishti:** PZHK po shihet se është duke u vonuar, ndërkaq nëse ne si KK i bllokojmë kërkesat e qytetarëve për ndërrimin e destinimit të tokave, atëherë nuk e di ata se kur me bërë kërkesa tjera. Ne si KK edhe pse nuk e dimë paraprakisht pa e dërguar në ministri se qysh ka me qenë vlerësimi i ligjshmërisë, ne duhet me dhënë maksimumin që kërkesat e tyre me u shqyrtuar në KK, pasi PZHK nuk e dimë se kur vjen.

**z. Agim Mani:** Po dua të ndërlidhem me këtë çështje, pasi parafolësi i juaj na u drejtua si subjekt, kur e dimë që PDK e ka udhëheqë komunën që 24- 25 vjet dhe gjendja e komunës tonë është kështu si është. Kaçaniku nuk ka ndërtime të larta, si rezultat i qeverisjes është shprazë komuna jonë. I keni numrat, e keni ekzekutivin, kaloni çështjet, zhvilloni komunën, ndërkaq mendësia e qeverisjes është e njëjtë që ka ngecë komuna jonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për atë është vlerësuar komuna jonë që 25 vjet.

**z. Agim Çaka:** Planifikimi është që diçka duhet me bërë me plan. Çdo gjë që bëhet pa plan është keq. Këto çështje duhet paraqitur atje, PZHK, Hartat zonale, ku është tokë ndërtimore, tokë bujqësore. Se vjen puna me dhënë tokë në shfrytëzim, nëse dikush donë me investuar diçka. Duhet shikuar çështjet, ku kush çka po bënë në zona ndërtimore, turistike, turizëm rural, mos me bërë diçka në ndonjë vend ku nuk duhet. Planifikimin duhet me pasur kujdes ku çka bënë, e jo mos me iu dhënë njerëzve në pronë të vet me ndërtua. Ndërrimi i destinimit nuk duhet me qenë problem, por duhet të jetë në harmoni me rregullat ligjore.

**z. Rrustem Zenuni:** Nuk mundeni me thënë 25 vjet qeverisje nuk është bërë asgjë, se cilës lagje a vendbanim i mungojnë çështjet elementare të jetës. Janë ambulancat, shkollat, ofiqaria, kanalizim, ndriçim, ujësjellës. Nuk kanë migruar shkaku jonë, por kanë migruar se është bërë jeta dinamike, dhe qytetari po donë me pasur punën me afër e jo me udhëtuar. A kemi bërë mjaftueshëm, jo, duhet bërë edhe tepër. Janë duke mbetur shumë pak njerëz, por nuk kemi çka me bërë, kapaciteti i ynë është i lidhur edhe me juve, ju jeni bërë pothuajse shumica pjesë e partive tjera për shkak se nuk keni mundur me gjetur vetën me u avancuar dikund, me u bërë drejtor, kryetar, kryesues, keni migruar. Tepricat e partive tjera e kanë krijuar një subjekt qysh jeni ju. Keni bërë gjithçka, 51% hajni, vjedhje, mashtrim, 500 kontrata njëburimore.

**z. Naim Beça:** Problemi është që u përmend se nuk shkojmë të varrezat, u përmend se jemi nga tepricat e partive tjera, nuk po e kuptoj këtë çështje, ne jemi këta që jemi. Ne jemi LVV. Ku kam qenë unë, ku kanë qenë personat tjerë, ky nuk është problemi i juaj.

**z. Bashkim Luma:** Asnjë anëtar i KK nuk guxon me u lëshuar në akuza të rënda dhe të pabaza sikurse kolegu. Nuk është e moralshme me thyer dinjitetin e dikujt, pa bazë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Njëjtë është, së pari akuzoj Agimi, pastaj ai. E përfundojmë këtë çështje.
**z. Selajdin Troni:** Nuk është e pabazë, kur ju paguheni prej taksave të qytetarëve, pa punuar fare. Kjo shkon në dëme të buxhetit. Ju i merrni pagë në bordin e ndërmarrje, vjen këtu në 2-3 seanca merr pagë pa punuar, se nuk qëndron në seancë, ndërkaq unë në krejt komisionet që jam, nuk paguhem.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 17 votë Për, Kundër 6 anëtarë të LVV, Abstenuan 2: Raif Kasa dhe Betim Shala. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-8930/24.**

**5.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa kam informacion, kjo është tokë e privatizuar nga AKP. Pala ka shprehë dëshirë me investua në panele solare, dhe kërkon me ia ndërruar destinimin pronës.

Meqë është investim strategjik, edhe ministria e trajton me prioritet, megjithatë KK duhet me trajtuar këtë çështje. E hapi diskutimin: Fillimisht drejtori e ka një përmirësim:

**z. Qamil Stagova:** Në Propozim Vendim është bërë një gabim teknik në sipërfaqe që i ndërrohet destinimi, se fjala është për krejt parcelën, diku 38 ha.

**z. Agim Mani:** Ne edhe në mbledhjen e KPF kemi qenë kundër procedurave, por nuk jemi kundër investitorëve që shprehin gatishmërinë me investuar në komunën tonë. Ne kemi thënë që në këtë formë mos me ardhur në KK, se ekziston mundësia mos me kaluar dhe pëson investitori në këtë rast. Propozim Vendimi fillimisht nuk ka bazë juridike. Në propozim Vendim thuhet që është pronë e klasës 5 dhe 6, në realitet në fletë poseduese është edhe pronë e klasës 3. Prona është në shfrytëzim për 99 vjet. A e dini që është në hipotekë kjo parcelë? Fletën poseduese e keni sjellë jo të pastër, për mos me u kuptuar që kjo parcelë është në hipotekë.
**Kryesuesi i Kuvendit:** A e pengon hipoteka investimin? Në aspektin ligjor, hipoteka nuk e pengon investimin, se vlera po i rritet pronës, hipoteka e pengon vetëm tjetërsimin.

**z. Agim Mani:** Ne kemi qenë kundër, dhe duhet me i qëndruar asaj që kemi qenë kundër. Për me ardhur në KK kjo çështje, fillimisht personi në fjalë është dashur me bërë kërkesë. Në vazhdim z. Mani e lexoj kërkesën e palës, sipas të cilës pala ka kërkuar që parcelës në fjalë t'i ndërrohet destinimi me PZHK nga tokë bujqësore në ndërtimore për panele solare. Ju nuk po e ndryshoni me PZHK, por me KK. Investimi është afatgjatë dhe nëse e vendosë në KK, ju bini në kundërshtim me PZHK. Ne kemi qenë kundër edhe për gabime teknike, komisioni ka dalë në vendngjarje, ka konstatuar se parcela në fjalë gjendet në atë zonë. Komisioni i ka propozuar drejtorisë Urbanizmit që të lejohen ndërrimi i destinimit të pjesës së parcelës kadastrale 00167-0 në sipërfaqe 1100.00m2 me kulturë arë e klasës 3. Unë edhe në mbledhjen e KPF kam kërkuar që kjo pikë t'i kthehet komisionit, që t'i përmirësojnë gabimet e veta, se unë jam me kaluar kjo lëndë se janë investitor serioz, por jo në këtë formë. Shikoni si komisioni ka lejuar me bërë ndërrimin e destinimit në parcelë krejt tjetër e jo në atë që po thuhet. Ju i keni numrat, mund ta kaloni, por të jeni të bindur që ministritë e linjës kanë me kthyer prapa dhe atëherë dilni ju joserioz, se mund t'ia hidhni fajin ministrisë, por jo punën duhet me kryer vet. Nuk e di për sa sipërfaqe bëhet fjalë, këtu po thuhet për 1100.00m2, nëse është ndryshme, me shpjegoni dikush.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Është gabim që komisioni e ka cekur vetëm një parcelë, a është gabim apo me qëllim, nuk e di, është edhe një parcelë tjetër e cila është tokë jobujqësore. Atë parcelë nuk e kanë trajtuar fare drejtor. Meqë janë këto parregullsi, atëherë kjo duhet t'i kthehet edhe njëherë komisionit për vlerësim.
**z. Agim Çaka:** Theksoj se nuk e njoh firmën në fjalë, as nuk kam njohuri për investimin, por çështja është se hartimi i kërkesës është skandaloze, me shumë gabime teknike. Unë kështu drejtor nuk e kisha pranuar një kërkesë të tillë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kompanitë i kanë përfaqësuesit e tyre, lënda i vjen drejtorit përmes protokollit.

**z. Rrustem Zenuni:** Në fletë poseduese janë disa parcela, ndërkaq në Propozim Vendim është vetëm 1 parcelë. Nëse kishim pasur mundësi me kaluar, se investitori është serioz, kështu që e ia dhënë mundësinë, pastaj lënda të kompletohet me dokumente tjera të nevojshme.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pa vlerësim të komisionit lënda nuk mundet me kaluar, se komisioni është profesional.

**z. Agim Mani:** Unë kam reaguar me kohë në KPF, kam kërkuar që lënda të kthehet në komision dhe të shqyrtohet me hollësisht., pastaj lënda kur të kompletohet t.na vjen në KK.

Lënda i ka kaluar filtrat, nga komisioni në DUKMM, KPF dhe tani na ka ardhur këtu, por neglizhenca ndaj këtij propozim vendimi ka ardhur në këtë situatë. Unë jam për me rregulluar njëherë, pastaj me kaluar lëndën.

**z. Rrustem Zenuni:** Ky Propozim Vendimi duhet me marrë miratimin sot në KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A jeni që lënda të kthehet në rishqyrtim të organit propozues/ Njëzëri u pajtuan të gjithë. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se KK mori këtë:

**VENDIM**

**Për kthimin në Rishqyrtim të Propozim Vendimit të DUKMM për shkak të paqartësive të tij dhe Procesverbalit të komisionit vlerësues, mbi bazën e të cilave vendoset çështja në KK/ Lënda: 01 Nr. 06 Nr. 350/02-9007/24.**

**6.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të "Dream Palace" SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi;

Edhe këtu është e njëjta çështje. E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Edhe këtu e ndajë mendimin e njëjtë, me diskutimin që e pata për pikën 4, ndërkaq nuk kam asgjë personale. Edhe këtu nuk është përmend Ligji për tokat bujqësore dhe lënda është pa nënshkrimin e Kryetarit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Këto janë çështje teknike që mund të rregullohen në vendim, ndërkaq diçka përmbajtjesore nuk ka me u kontestuar. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim me k]to përmirësimet dhe e njëjta u aprovua me 17 votë Për, Kundër ishin 6 anëtarë nga LVV, Abstenime 2, Raif Kasa dhe Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të "Dream Palace" SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-8928/24.**

**7.** Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E potencuam fillimisht që raporti ka ardhur me vonesë. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Unë isha kundër procedurave, sepse sipas Planit të punës së KK për vitin 2024, Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2023, duhet me na ardhur në mbledhjen e dytë të KK. Raporti është vonuar dhe është i pakompletuar në përmbajtje. Edhe në vitin e kaluar, raporti i këtij komiteti ka ardhur në muajin e 5-të apo të 6-të. Ne jemi kundër, pasi që raporti duhet të miratohet sipas Planit të punës së KK të vitit 2024, raporti duhet me na ardhur me kohë dhe të jetë përmbajtjesor.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pajtohem që raporti duhet me ardhur me kohë. Për punën që bëjnë, ky komitet paguhen jo pak. Është mirë me qenë të përgjegjshëm anëtarët e këtij komiteti dhe raporti me ardhur me kohë.

**z. Naim Beça;** Cila është arsyeja me u miratuar raporti?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komiteti për Komunitete është trupë punuese e KK dhe i raporton KK. Nëse nuk miratohet raporti, kjo përbërje e këtij komiteti shkarkohet.

**z. Naim Beça:** Për gjendjen e sigurisë, është dashur me u shkruar me shumë në raport, se janë nja 3 rreshta, është dashur nja 10 faqe. Të subvencionet, lavdërohet komuna, kurse në fund nuk ka rezultate. Si ka mundësi me pasur rezultate, ku për një klub sportiv ndahen 1000€, ndërkaq i ka 50 anëtarë. Në vend se me kërkuar me u rritur subvencionet, keni thënë se klubet e sportit nuk kanë efikasitet. Nuk ka klub në botë që mundet me arritur suksese me 1000€. Janë 20-30 gara në vit i një klubi sportiv dhe me ato mjete as shpenzimet e derivateve është vështirë me i mbuluar. Të rreziku, është dashur me u cekur se shenjat e rrezikut nuk janë adekuate në komunën e Kaçanikut. Ata bile janë të rrezikshme për qytetarë dhe nuk janë në vende kyçe ku duhet me ligj. Çështja e qeneve endacak, nuk është përmend të rreziku, të cilët po shtohen dita ditës. Ka edhe shumë tema të tjera që nuk janë përmendur. Të dhuna në familje, gjatë vitit 2023 janë kanë 8 raste dhe është shqetësuese se është në rritje dhuna në familje. Duhet ditur sa ka qenë në vitin 2022 dhe uroj të jenë vetëm 8 raste në vitin 2023, shpresoj mos është bërë ndonjë gabim.
**z. Selajdin Troni:** Unë nuk jam i kënaqur me punën e këtij komiteti, edhe pse me kompensime janë mirë, pos anëtarit të OJQ i cili nuk është paguar. Ajo që me ka ra me pa, Vizita në OVL të UÇK u anulua për shkak të agjendave të festave të nëntorit, edhe pse ishte e konfirmuar. Një vit keni pasur kohë me dalë të veteranët, të familjet e dëshmorëve, të personat me aftësi të kufizuara, të njerëzit që kanë probleme, të QPS, të ambulancat, të shkolla etj. keni kohë 1 vit. Pagat i keni shumë të mira, saqë një njeri punon 1 muaj për pagën e juaj. Punoni me tepër që me i arsyetuar ato mjete që i merrni.

**z. Ekrem Livoreka:** Në komitetin e Komuniteteve i kemi përfaqësues nga 4 parti politike, dua me ua përkujtuar secilës parti se çfarë anëtarë kanë emëruar në këtë komitet, sa thirrjet e kam bërë dhe sa janë përgjigjur thirrjeve për vizita. E kam marrë veturën e komunës, kam nënshkruar dhe e kam kthyer prapë, se asnjë nuk iu kanë përgjigjur thirrjes time. Disa herë anëtarëve të këtij komiteti ua kam tërhequr vërejtjen. Unë nuk e di, a ju informojnë juve dhe për çka paguhen? Asnjë pyetje nuk ia bëjnë as drejtorit as askujt.

**znj. Arta Avdiu:** Nuk duhet me përfshirë edhe mua, se unë jam active në këtë komitet.

**z. Ekrem Livoreka:** Në vizita nuk keni ardhur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Problemet e juaja i trajtoni në komitet, ndërkaq këtu jemi duke debatuar për raportin, që shumica po thonë vlen për t'u dëshiruar. Kjo është një vërejtje nga KK, për punën e juaj. Të paktën kryesues, në listë janë të shënuar emrat e pjesëmarrësve, se po marrin pjesë në mbledhje, mëditjet po i marrin, ndërkaq këtu thoni se nuk po vijnë në vizita në terren. Atëherë mos i ftoni as mbledhjet, mbajë vetëm 2 mbledhje për një vit. Kushdo me punuar, thirri, ata që nuk duan me punuar, mos i thirr. Të paktën merrni mësim në raportet tjera, siç është i KPF, e mos shkoni aty vetëm për përfaqësim. Kontribut keni mundësi me dhënë, kështu që të paktën dilni pak me serioz në dokumentet që i raportoni.

**z. Ekrem Livoreka:** Mundem edhe ashtu kryesues, pa problem. Për takimet e OVL, një javë përpara e bëjmë ftesën. Ne nuk mundem një vit përpara me bërë ftesën, por kur e kemi në agjendë çështjen. Ata na kanë thënë se kanë disponim me na pranuar, por për shkak të agjendës na kanë kthyer përgjigje se nuk mundem me iu pranuar.

**z. Rrustem Zenuni:** Për anëtarët e këtij komiteti të emëruar nga KK, keni pasur mundësi kryesues me i shprehur shqetësimet në mbledhje të KK për mospjesëmarrje, e jo me neglizhuar këtë çështje, se nuk mundeni me funksionuar kështu. Ai që nuk është i interesuar me punuar, hiqet se edhe i bënë me të përgjegjshëm me punuar në këtë drejtim. Kjo është dashur me u cekur edhe në raport, se unë jam për një komision funksional, ai që nuk angazhohet, me u shkarkuar.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Cila ka qenë neglizhenca e kryesuesit?

**z. Rrustem Zenuni:** E kam fjalën për kryesuesin e Komitetit për Komunitete.
**Kryesuesi i Kuvendit:** E mendova mos e keni fjalën për mua.

**z. Naim Beça:** Unë nuk e nënçmova punën e juaj, por raporti për një vit kaq i shkurtër, nuk ka logjikë. Në raport është dashur me u përmendur edhe shumë tema tjera. Problemet keni pasur mundësi me i shfaqur kryesues i komitetit, që nuk kanë ardhur në mbledhje drejtorët, kryetari. Sa për çështjen e kompensimit, mos të përmendet disa herë, se ligji ua mundëson kompensimin.

**z. Agim Çaka:** Jo vetëm në këtë komitet, por kushdo që emërohet në ndonjë komitet apo komision, duhet me punuar për çka është emëruar, edhe nëse është pa pagesë, e aq me keq nëse paguhen e nuk punojnë. Kjo lë të jetë mesazh dhe për komitetet e komisionet tjera, për secilin që merr pagë dhe nuk punon apo e merr një përgjegjësi e nuk punon.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në Komitetin për Komunitete, secili i ka përfaqësuesit e vet, është në përgjegjësi e subjekteve politike që secili të merret me përfaqësuesin e vet.

**znj. Arta Avdiu:** Kryesuesi i Komitetit për Komunitete është dashur me raportuar në KK për neglizhencën e punës së këtij komiteti. Për atë e potencova që t'i përmend me emra, kush ka qenë i rregullt në këtë komitet, e kush e ka neglizhuar punën. Anëtari nga partia e juve-PDK Lejla ka qenë joaktive në këtë komitet, pastaj anëtari nga LDK Betimi. Këto çështje është dashur me raportuar në KK kryesuesi i këtij komiteti.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përse Arta nuk e keni ngritur deri me tani këtë çështje në KK që nuk jeni duke punuar mirë si komitet? Për mos prezencë nuk merret mëditja, nuk është puna veç me ardhur me nënshkruar për mëditje dhe me ecur. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Raportin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 18 votë Për, Kundër ishin 4 anëtarë nga LVV, Abstenuan 3, Naim Beça, Raif Kasa dhe Rrustem Zenuni. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

**VENDIM**

**Me të cilin e Aprovoj Raportin e punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-9631/24.**

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:21. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët -25 të cilët morën pjesë në këtë mbledhje.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPSTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

KAÇANIKU

Drejtoria për Kulturë,Rini e Sport

LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

| | |
|---|---|
| REFERENCË | 03-104/02-11431/24 |
| PËR/ZA/TO: | Kryesuesin e Kuvendit,Kemal Murseli |
| Kopje: | |
| NGA/OD/FROM | Drejtoresha për Kulturë,Rini e Sport,<br>Hafize Sallahu ________ |
| LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Draft Statuti i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut |
| DATË/E | 16.05.2024 |

REPUBLIKA E KOSOVES * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPSTINA KAÇANIK * REPUBLIKA KOSOVA

I nderuar,

Pas hartimit të Draft Statuti i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut nga Këshilli Punues i emëruar me vendim të Kuvendit Komunal dhe pas kalimit të këtij Drafti në të gjitha procedurat, këtë dokument ua përcjellim për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës .

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPSTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

KAÇANIKU

Bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 (pika d)dhe nenin 17, (pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 6 paragrafi 1 të Statutit të komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008), nenit 12, paragrafit 12.2. dhe 12.5 dhe Neni 14 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut , në mbledhjen e mbajtur me datën ........................, miraton:

# DRAFT STATUTI I MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

Maj 2024

## DISPOZIT AT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohen dhe rregullohet mandati, veprimtaria, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, historiku, themelimi, funksionimi, statusi juridik, emërtimi, selia, vula dhe shenja dalluese (logo), pozita juridike, organizimi i brendshëm dhe administrimi, burimet e financimit dhe projektet, përfaqësimi, përzgjedhja dhe organizimi i punonjësve profesional, administrativ dhe teknik, bashkëpunëtorëve të jashtëm si dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese për dhe rreth Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

### Neni 2

### Historiku i Muzeut

Muzeu i Qytetit të Kaçanikut është institucioni i parë i këtij lloji në Komunën e Kaçanikut, i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me Nr. 01 Nr.09-60/01-25460/22 të datës 29.09.2022 me qëllim të arkivimit, selektimit, ruajtjes dhe promovimit të relikteve, dokumenteve si dhe gjësendeve tjera të trashëgimisë së luajtshme kulturore me peshë historike individuale dhe shoqërore, duke filluar që nga periudha parahistorike, periudhat historike në vijim, përfshirë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e deri më sot.

### Neni 3

### Statusi

1. Kompetencat, mandati, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe organizimi dhe funksionimi i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut rregullohet me Ligjin Nr. 02/L - 057 për Institucionet e Kulturës, Ligjin Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, këtë Statut dhe aktet nënligjore përkatëse.

2. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut është institucion kulturor, lokal, publik, kërkimor - shkencor, arkivor i pavarur nga partitë e grupimet politike, institucionet

apo organizatat fetare, i cili menaxhohet nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3. Muzeu ka status të personit juridik publik dhe në kuadër të përcaktimit të statusit të Organeve të Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore dhe Rregullores përkatëse për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, ka statusin e organit lokal të administratës, në vartësi të Komunës së Kaçanikut, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

**Neni 4**

**Emërtimi, selia, vula dhe logo**

1. Emërtimi i institucionit është Muzeu i Qytetit të Kaçanikut.

2. Akronimi i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut është MQK.

3. MQK- ja ka selinë në Bulevardin "Ismajl Raka" nr. 200, objekti i Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj", në Kaçanik.

4. MQK- ja ka logon, vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore.

4.1. Vula e rrumbullakët përmban këto të dhëna: në rrethin e parë shkruhet Republika e Kosovës-Komuna e Kaçanikut, në rrethin e dytë shkruhet: Muzeu i Qytetit të Kaçanikut, në mes horizontalisht shkruhet akronimi MQK.

4.2. Vula katrore përmban këto të dhëna: në rreshtin e parë shkruhet: Republika e Kosovës-Komuna e Kaçanikut, në rreshtin e dytë shkruhet: Muzeu i Qytetit të Kaçanikut, në rreshtin e tretë shkruhet: Njësia, numri i protokolit,viti, data.

5. Logo e MQK-së (përshkrimi i logos): Emri i institucionit: "Muzeu i Qytetit të Kaçanikut", kurse për paraqitjen grafike të logos (simbolin) do të zhvillohet konkurs publik i shpallur nga organet drejtuese të institucionit.

**Neni 5**

**Veprimtaria dhe detyrat e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut**

1. Veprimtaria e MQK-së është e rëndësisë së veçantë të interesit publik dhe shtrihet në gjithë territorin e Komunës së Kaçanikut.

2. MQK-ja veprimtarinë muzeore, detyrat dhe kompetencat e tij i përcakton me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, MQK-ja është përgjegjës për kryerjen e detyrave si më poshtë:

Zbaton politikat dhe strategjitë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore të luajtshme, përmes realizimit me standarde shkencore dhe profesionale të hulumtimit, mbledhjes, inventarizimit, studimit, mbrojtjes dhe ruajtjes, konservimit dhe restaurimit, ekspozimit dhe promovimit të objekteve potenciale me vlera të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, veçanërisht arkivimin, seleksionimin, promovimin, ruajtjen dhe konservimin e materialeve arkivore, dokumenteve, fotografive, video-incizimeve, gjësendet e të gjitha periudhave historike, përfshirë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e deri më sot.

3.1. Inkurajon dialogun apo debatet me komunitetin e profesionistëve, si dhe qytetarëve, përmes zhvillimit të komponentëve të edukimit, kërkimeve dhe botimeve të bazuara mbi studimin e materialeve muzeore;

3.2. Siguron mbledhjen, ruajtjen, konservimin/restaurimin dhe studimin e provave materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike dhe kulturore e të gjitha periudhave historike, të cilat i ekspozon dhe i paraqet në hapësira apo platforma të ndryshme dhe adekuate që nxisin kureshtjen, debatin dhe edukimin.;

3.2.1. Një material i luajtshëm, i cili me arsye mendohet se përfaqëson një m

**Neni 6**

**Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar**

1. MQK-ja bazuar në Ligjin Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin Nr.02/L-057 për Institucionet e Kulturës, këtë Statut dhe aktet tjera nënligjore në fuqi zhvillon bashkëpunim dhe bashkëveprim institucional me organet e tjera të administratës shtetërore qendrore, rajonale dhe lokale si dhe muzetë rajonale, muzetë tipologjike, muzetë lokale, muzetë private, koleksionuesit, pronarët, poseduesit dhe shfrytëzuesit eventual të objekteve potenciale muzeore në cilësi të personave fizik, për të tërhequr nga fondet e tyre apo për përdorim të përkohshëm të objekteve, me qëllim të ekspozimit të tyre në ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta, apo edhe për qëllime të studimit dhe hulumtimit.

2. MQK-ja mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me ente, subjekte private apo shtetërore të huaja, në formën e binjakëzimit të parapara sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim të realizimit të projekteve të financimit, ekspozimit, zhvillimit të aktivitetetеve kulturore, promovuese.

## ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

### Neni 7

### Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të MQK-së janë:

   1.1. Këshilli Drejtues;

   1.2. Drejtori.

### Neni 8

### Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues i MQK-së përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve me mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

2. Këshilli Drejtues i MQK-së emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi Komunal.

3 Përbërja e Këshillit Drejtues të MQK-së është si vijon:

3.1 Dy anëtarë nga Organizatat e dalura nga Lufta e UÇK-së në Kaçanik;

3.2 Tre anëtarë nga komuniteti shkencor-profesional;

3.3 Një përfaqësues nga Shoqëria Civile;

3.4 Një përfaqësues nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4. Njëri prej shtatë (7) anëtarëve duhet të jetë përfaqësues i Komunës së Kaçanikut, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pa të drejtë që të zgjedhet kryetar i Këshillit.

5. Punën e Këshillit Drejtues e udhëheq kryetari i KD-së, i cili zgjidhet me shumicë votash nga anëtarët e Këshillit.

6. Mbledhjet i thërret dhe i udhëheq kryetari i Këshillit. Mbledhjen e parë të Këshillit e thërret dhe e udhëheq anëtari më i moshuar i Këshillit.

7. Anëtarët e Këshillit Drejtues për punën e tyre kompensohen financiarisht.

8. Anëtarët/et e Këshillit Drejtues të MQK-së kompensohen në shumë prej 100.00 € (njëqind euro) për secilën mbledhje të mbajtur gjatë vitit, përkatësisht për 12 mbledhje brenda një viti kalendarik. Pagesa do të bëhet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës. Dëshmi për pagesë do të jetë lista e pjesëmarrjes për mbledhjen e mbajtur të Këshillit Drejtues.

**Neni 9**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**

1. Harton Statutin e MQK-së të cilin i miraton Kuvendi i Komunës.
2. Harton aktet të ndryshme normative të MQK-së.
3. Harton dhe aprovon politikat afatgjata zhvillimore të MQK-së.
4. Aprovon programin vjetor të punës dhe buxhetin vjetor të MQK-së si dhe ka qasje në dokumentacionin e rregullt dhe llogari mbajtjes.
5. Këshilli Drejtues mund të kërkojë që së paku një herë në vit, dhe në raste të veçanta, që llogaridhënia e muzeut të mbikëqyret nga nje auditor i pavarur.
6. Këshilli Drejtues bën vlerësimin e punës së drejtorit dhe të MQK-së në përgjithësi dhe për këtë i raporton Kuvendit të Komunës.
7. Këshilli monitoron, mbikëqyr dhe përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit, si edhe proceset e mundshme të ri konceptimit tërësor, apo pjesor të pavijoneve të ekspozitave, duke nxjerrë rekomandime.
8. Këshilli Drejtues propozon te themeluesi ndërrimin apo zgjerimin e veprimtarisë së MQK-së.
9. Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
10. Harton rregulloret e nevojshme për funksionimin e MQK-së, nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj apo akt të veçantë nënligjor.
11. Harton dhe miraton rregulloren e punës.

**Neni 10**

**Drejtori i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut**

1. Drejtori është udhëheqës dhe organi më i lartë ekzekutiv i MQK-së.
    1.1. Drejtori zgjidhet me konkurs publik të shpallur nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

1.2. Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në njërën nga fushat si ajo e historisë, arkeologjisë, etnologjisë, muzeologjisë, politikave publike të trashëgimisë kulturore.

1.3. Mandati i drejtorit të MQK-së është katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

## Neni 11

## Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Drejtori organizon, koordinon dhe udhëheq veprimtarinë dhe funksionimin e MQK-së, i propozon dhe i raporton Këshillit Drejtues planin e punës dhe planin vjetor financiar.
2. Merr pjesë kur ftohet në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.
3. Përfaqëson MQK-në brenda dhe jashtë shtetit.
4. Kërkon, aplikon dhe negocion marrjen e donacioneve dhe përgjigjet për to.
5. Mbikëqyr të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe donacionet.
6. Negocion dhe nënshkruan marrëveshjet për bashkëpunim.
7. Menaxhon bashkëpunimin muzeor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Informon me shkrim Këshillin Drejtues për punën gjashtëmujore të MQK-së.
9. Harton me shkrim raportin e aktiviteteve dhe raportin financiar dy herë në vit dhe informon dhe raporton në Këshillin Drejtues.
10. Ushtron detyra dhe përgjegjësi tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.
11. Ekzekuton vendimet e Këshillit Drejtues të MQK-së.
12. Përgjigjet për menaxhimin e financave dhe aseteve të MQK-së.
13. Propozon rregulloret e punës të cilat i aprovon Këshilli Drejtues dhe organi më i lartë në hierarki.
14. Obligohet të respektojë dokumentet e pranuara ndërkombëtare të profesionit dhe veprimtarisë së muzeve siç janë: Statuti i Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve dhe Kodi i Etikës Profesionale (ICOM).
15. Nxjerr udhëzime, urdhëresa, vendime dhe akte të tjera me të cilat udhëheq dhe orienton personelin e punësuar në MQK, në përmbushjen e detyrave zyrtare dhe profesionale në funksion të realizimit të veprimtarisë dhe mandatit të institucionit.
16. Është autoritet që vendos së bashku me këshillin drejtues për lëvizjet,

përdorimin, ripërdorimin, trajtimin veç e veç apo çfarëdo liste të objekteve me vlerë muzeore që janë pjesë e koleksioneve të Muzeut, për çfarëdo procesi të trajtimit të tyre, brenda territorit të Republikës së Kosovës, nën kushtet përkatëse të sigurisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

17. Vendosë për kohëzgjatjen e ekspozitave të përkohshme.

**Neni 12**

**Fondi Muzeor**

1. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut administron fondin e vet muzeor dhe obligohet që ta ruajë të gjithë materialin muzeor, artefaktet, eksponatet, materialet historike, aparaturat, instrumentet, veglat e ndryshme, dokumentacionin teknik si dhe materialet e tjera me vlerë muzeore (fototeka, diapozitivat, negativet, video dhe audio inçizimet).

2. Ruajtja, konservimi dhe menaxhimi i këtij fondi kryhet sipas rregullave të miratuara nga institucionet e specializuara në vartësinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, standardeve ndërkombëtare profesionale, si dhe rregulloreve të brendëshme të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

3. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut dhe muzetë e tjera publike ose private shkëmbejnë ndërmjet tyre objekte muzeore, pas miratimit të Këshillit Drejtues, në përputhje me legjislacionin, si dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së ndersjellë ndërmjet tyre.

4. Fondet e muzeut pasurohen vazhdimisht me objekte të trashëgimisë kulturore. Për këtë funksionon një komision i përbërë prej 5 personash, 3 specialistë të institucionit dhe 2 nga institucione të tjera të specializuara. Komisioni ngrihet me propozim të drejtorit, miratohet nga Këshilli Drejtues dhe mblidhet në çdo tre muaj.

5. Fondet e reja muzeore regjistrohen në inventarin e institucionit, i cili hartohet dhe administrohet nga MQK-ja.

**Neni 13**

**Stafi profesional i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut**

1. Në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, detyrave dhe kompetencave të tij, MQK-ja organizon njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar profesional të trashëgimisë kulturore që do të mbështesin procesin e hulumtimit, mbledhjes, inventarizimit, studimit, mbrojtjes, ruajtjes, konservimit dhe restaurimit, ekspozimit dhe promovimit të objekteve potenciale

me vlera të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

2. Organizimi, sistematizimi dhe kompetencat e njësive organizative dhe të punësuarve në këto njësi, bëhen me aktin përkatës normativ sipas rregullave dhe parimeve të organizimit të institucioneve publike dhe të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës.

**Neni 14**

**Stafi administrativ dhe teknik**

1. Përveç stafit profesional MQK-ja ka edhe stafin administrativ dhe stafin teknik.

2. Numri i punëtorëve të stafit administrativ dhe teknik, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen me aktet normative mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

3. Stafi administrativ dhe stafi teknik i përgjigjen drejtpërdrejtë drejtorit të MQK-së.

4. Në rast të mos përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe atyre të veçanta të marrëdhënies së punës si dhe detyrave tjera zyrtare dhe profesionale nga stafi profesional, administrativ dhe teknik, drejtori i institucionit është përgjegjës për inicimin, propozimin dhe marrjen e masave disiplinore, konform ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, statutit si akt i brendshëm dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktet e themelimit të marrëdhënies së punës, gjegjësisht referencave.

**Neni 15**

**Përgjegjësia, masat dhe procedurat disiplinore të stafit të punësuar në Muzeun e Qytetit të Kaçanikut**

1. Kategoritë e të punësuarve në MQK, si punonjësit profesional, shërbyesit civil dhe stafi administrativ - teknik, në rastet e dështimit të përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të marrëdhënies së punës, respektivisht në rastet e dështimit të përmbushjes në kohë, sasi dhe cilësi të detyrave të punës, i nënshtrohen procedurave të brendshme disiplinore, gjegjësisht bartin përgjegjësi disiplinore në pajtim me Ligjin e Punës, Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet e tjera nënligjore, sipas llojit të aktit të themelimit të dhënies së punës, respektivisht, burimit juridik mbi bazën e të cilit është lidhur akti përkatës i marrëdhënies së punës.

2. Drejtori i MQK-së, në zbatim të detyrimeve të tij për të siguruar ligjshmërinë e punës dhe për të garantuar funksionimin e MQK-së, pas verifikimit të gjendjes faktike të shkeljes apo dështimit për të kryer me sukses detyrën është përgjegjës për shqiptimin e masave disiplinore për ato shkelje apo dështime në kryerjen e detyrës së punës, të cilat bazuar në ligjet dhe aktet normative në fuqi, konsiderohen shkelje të lehta të detyrave të punës

3. Drejtori i MQK-së në zbatim të detyrimeve të tij për të siguruar ligjshmërinë e punës dhe për të garantuar funksionimin e MQK-së, është përgjegjës për emërimin e organeve të brendshëm përkatëse për zhvillimin e procedurave disiplinore dhe procedurave të ankesave, të cilat merren me shqyrtimin e rasteve kur dyshohet se kanë ndodhur shkelje të rënda të detyrave të punës.

4. Për kategoritë e të punësuarve që i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, marrëdhënia e punës e të cilëve është rregulluar me Ligjin e Punës dhe akte tjera nënligjore, organet e brendshme të themeluara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, në punën e tyre, sa i përket procedurave të punës, do të zbatojnë përshtatshmërisht aktet nënligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës për aq sa zbatimi i tyre nuk nënkupton shkelje të parimeve, procedurave dhe dispozitave tjera materiale të ligjeve përkatëse në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës.

**Neni 16**

**Bashkëpunëtorët e jashtëm të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut**

1. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut mund të angazhoj bashkëpunëtorë të jashtëm për nevojat e brendshme.

2. Mënyra e angazhimit dhe kompensimit material të bashkëpunëtorëve bëhet konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi dhe me këtë Statut.

**Neni 17**

**Mënyra e financimit**

1. Mjetet buxhetore për punën e MQK-së sigurohen nga Komuna e Kaçanikut.

2. MQK-ja realizon mjete buxhetore edhe nga të hyrat vetanake, donacionet, sponsorizimet si dhe burime të tjera në përputhje me ligjet në fuqi.

3. Shfrytëzimi i donacioneve dhe të hyrave vetanake bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. MQK-ja ka xhirollogarin e mëvetëhsishme në njërën nga bankat e

licensuara të Kosovës.

5. Komuna e Kaçanikut angazhon një herë në vit një auditor për auditimin e pasqyrave financiare të MQK-së.

**Neni 18**

**Ndërtesa, hapesirat dhe infrastruktura e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut**

1. MQK-ja përkohësisht do të vendoset në ambientet e Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, deri sa të krijohen kushtet për një ambient më të përshtatshëm.
2. Hapësirat e MQK-së përbëhen prej sallave apo galerive, të cilat shërbejnë si salla të ekspozitës së përhershme, kurse disa eksponate janë të ekspozuara edhe në hollin qëndror të institucionit.
3. Në kuadër të MQK-së gjenden hapësirat e depove, ku ruhen koleksionet.

**Neni 19**

**Arkivi**

1. MQK-ja duhet të ketë të paktën 1 (një) arkivist kur të krijohen bazat financiare.
2. MQK-ja obligohet të ruajë gjithë dokumentacionin, regjistrin themelor, librat e inventarizimit, librat hyrës dhe dalës (informatorë, fletëpalosje, broshura, pllakatë, kataloge, fototekë, foto dhe audio dhe video inçizime, artikuj të gazetave të ndryshme, revista dhe materiale tjera), që formojnë dhe pasqyrojnë historinë dhe veprimtarinë e Muzeut, në arkivin e tij, në pajtim me Ligjin për Arkivat Shtetërore dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 20**

**Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi pas aprovimit në Kuvendin komunal , 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në ëeb faqen Komunës së Kaçanikut.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01– 104/02- 11705/24
Kaçanik; 20.05.2024

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit te Buxhetit 08-L/260 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës propozon:

**P r o p o z o n**

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës që zhvillohet në muajin Maj 2024, të shqyrton dhe aprovon këtë:

# V E N D I M
## PËR BARTJEN E TË HYRAVE TË TEJKALUARA NGA VITI 2023 NE VITIN 2024

**I**

Të Hyrat Vetanake (Fondi 21, gjobat e Gjykatave, Policisë dhe AGJPK) të realizuara gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithësej 1,092,788.68 euro ndërsa planifikimi vjetorë ka qenë 862,578.00 euro. ***Tejkalimi i të hyrave është në shumë prej 230,210.68 euro.***

**II**

Tejkalimi i të hyrave vetanake komunale te vitit 2023 eshte realizuar sipas kategorive eknomike të shpenzimeve:
- Kategoria e Investimeve kapitale shuma prej 125,210.68 euro;
- Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve shuma prej 90,000.00 euro dhe
- Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve shuma prej 15,000.00 euro.

**III**

Destinimi apo kërkesa për bartje te kesaj shume planifikohet te bëhet:

a) PB – Zyra e Kryetarit - nënprogrami (16028), shuma prej 90,000.00€ ne kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve;

b) PB – Administrata e Përgjithshme - nënprogrami (16328), shuma prej 10,000.00€ ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe

c) PB – Buxhetimi - nënprogrami (17528), shuma prej 5,000.00€ ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe shuma prej 120,210.68€ ne kategorinë e Investimeve kapitale në projektin "Mjetet për bashkëfinancim të projekteve" me kod 86245.

d) PB – Infrastruktura rrugore - nënprogrami (18028), shuma prej 5,000.00€ ne kategorinë e Investimeve kapitale në projektin "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriqimit publik në rrugën Fadil Bunjaku" Biqec – Projekt i ri.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria per Buxhet dhe Financa.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVO

**Besim ILAZI,**
**Krytar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01-Nr.400/01-11581/24**
**Kaçanik; 17.05.2024**

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjit Nr. (Nr.08/L-260) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

# PROPOZIM VENDIM
## PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA REZERVA KOMUNALE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2024

Përmes këtij Propozim Vendimi,bëhet transferi i mjeteve nga Rezerva Komunale ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ne shumën e përgjithshme prej **25,000.00** euro, sipas tabelës të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-260 per vitin 2024, si në vijim:

**1.Transferet-fondi 10 (Granti Qeveritar)**

Nga Nën-Programi Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 20,000.00 €
→ **Transferohet**: Në Nën-Programin Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 20,000.00 €.

**2.Transferet-fondi 21 (Të hyrat vetanake)**

Nga Nën-Programi Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 5,000.00 €
→ **Transferohet**: Në Nën-Programin Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 5,000.00 €.

1. Pjesë përbërëse e këtij Propozim-Vendimi janë Formularet standard nga MFPT. të plotesuara me shumat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike te shpenzimeve.

2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

**Kryetari i Komunës:**

**Besim Ilazi** ____________

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
*Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament*

# KËRKESA PËR TRANSFER

## PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emri i organizatës buxhetore | Komuna Kaçanikut | Kodi | 652 |
| Emri i nën-programit | Infrastruktura rrugore | Kodi | 18028 |

Transferi/Rialokimi

| Kodi organizativ | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Burime te Financimit | Emërtimi i Projektet | Kodi i projektit | Kategoria shpenzimeve | Aprovimi i tanishëm | Shuma e ndryshimit | Aprovimi i ri | Buxheti Aprovuar/Rishikuar | Totali i shumës së transferuar/rialokuar | % Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 652 | 18028 | 0451 | 10 | Rezerva | | 38 | 20,000.00 | (20,000.00) | - | 20,000.00 | (20,000.00) | |
| 652 | 18028 | 0451 | 21 | Rezerva | | 38 | 5,000.00 | (5,000.00) | - | 5,000.00 | (5,000.00) | |
| 652 | 18028 | 0451 | 10 | Mallra dhe Sherbime | | 30 | 315,000.00 | 20,000.00 | 335,000.00 | 315,000.00 | 20,000.00 | |
| 652 | 18028 | 0451 | 21 | Mallra dhe Sherbime | | 30 | - | 5,000.00 | 5,000.00 | - | 5,000.00 | |
| | | | | Totali | | | 340,000.00 | - | 340,000.00 | 340,000.00 | - | |

## PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR

| | | PO | JO |
|---|---|---|---|
| (Shëno Po ose Jo) | Transferi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve | PO | |
| | Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parasë? | PO | |

## PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Eliminim i rezerves komunale behet pershkak te plotesimit te fondeve ne kategorine e mallrave dhe sherbimeve

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

| Zyrtari kryesor financiar | Data | Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv | Data |
|---|---|---|---|
| Valdrin Dogani | 17.05.2024 | Besim Ilazi | 17.05.2024 |

## PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)

| KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE | | NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA* | |
|---|---|---|---|
| Drejtor i Buxhetit | Data | Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave* | Data |
| Drejtori i Departamentit të Buxheteve Komunale z.Salvador Elmazi | | NUMRAT E KD | |

Vrejtje:
*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorin e shpenzimeve të nën-programit

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01-Nr. 400/01-11717/24
Kaçanik; 20.05.2024

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjit nr.(Nr.08/L-260) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

**P R O P O Z I M  V E N D I M**
**PËR RIALOKIMIN E MJETEVE BUXHETORE NGA BURIMI I FONDEVE 22 – TË HYRAT E BARTURA NGA VITI KALUAR 2023 NE BUXHETIN E VITIT 2024**

1. **Nga Nënprogrami buxhetorë 18028-Infrastruktura Rrugore, Kodi funksional 0451, nga projektet:**

-Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë-Nikoc-Kërbliq–Drenogllavë me kod 43987 shuma 5,000.00€;

-Rregullimi i trotuarit në rrugen Bob Doganaj me kod 46564 shuma 5,000.00€;

-Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve ndërkomunale me kod 48243 shuma 5,000.00€;

-Ndërtim i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza në dalje të pjesës jugore të zonës urbane të qytetit" me kod 48261, shuma 5,000.00€;

-Asfaltimi i rruges që lidhë Fshatrat Kotlinë-Ivajë me kod 51009, shuma 5,000.00€;

-Ndërtimi i stazës për këmbësorë dhe shtegut për biciklista përgjatë lumit Lepenc Kaçanik-H.Elezit" me kod 51013, shuma 5,000.00€;

-Ndertimi i kolektorit kryesorë per trajtimin e ujrave te zeza-Nerodime" me kod 51045, shuma 5,000.00€;

-Ndertimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin me kod 52699, shuma 6,313.00€;

-Ndertimi dhe asfaltimi i rrugës Ismail Raka, prej Shtepisë së Kulturës deri te Xhamia e Dëshmorëve" me kod 51628, shuma 5,000.00€;

-Asfaltimi i rruges Kaçanik i Vjeter – Begracë me kod 52818, shuma 5,000.00€;

-Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë Lumit Nerodime me kod 51645, shuma 12,453.60€

-Vendosja e tabelave dixhitale me mbishkrimin "Mirësevini në Kaçanik" me kod 51637, shuma 2,200.45€ dhe

-Rregullimi i ndriqimit publik në rrugën Hetem Hasaj–Gabrricë me kod 52809, shuma 1,022.18€

2. **Nga Nënprogrami buxhetorë 75636-Shërbimet sociale–Kaçanik, Kodi funksional 1040, nga projekti:**

-Ndërtimi i objektit të QPS-ës në Kaçanik me kod 52979, shuma 5,000.00€

**Rialokohen në kategorinë e Shpenzimeve kapitale:**
**Në nën programet buxhetore:**

a) **Infrastruktura Rrugore 18028, Kodi funksional 0451, në projektet:**

-Rregullimi i sheshit te qytetit - faza I-rë me kod 51036, shuma 17,453.60€;

-Ndertimi i trotuarit ne rrugen regjionale Ahmet Kaçiku segmenti Restaurant Natyra-Fushë e Pajtimit me kod 52705, shuma 16,022.18€;

-Ndertimi i kanalizimit ne fshatin Begracë me kod 52174, shuma 21,698.45€;

-Ndertimi i objektit per zjarrëfikësit – Kaçanik me kod 50170, shuma 6,815.00€;

-Ndertimi dhe asfaltimi i rruges Idriz Seferi – Kaçanik me kod 51631, shuma 5,000.00€.

b) **Shërbimet sociale–Kaçanik 75636 Kodi funksional 1040, në projektin:**

-Ndërtimi dhe funksionalizimi i objekteve për banim social me kod 51214, shuma 5,000.00€

1. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPSTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

**Kryetari i Komunës:**

**Besim Ilazi** ______________

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
*Departamenti i Buxhetit-Budžet Department-Budget Departament*

# KËRKESA PËR RIALOKIM

## PJESA 1: TË DHËNAT E RIALOKIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emri i organizatës buxhetore | | Kodi | |
| Emri i nën-programit | Infrastruktura Rrugore | Kodi | 18028 |

Rialokimi

